

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
---	---	---

11 maj 2012

SCC – 08 – 0304

A.Đ., XX

Përfaqësuar nga Halil Palaj, avokat nga Prishtina

Paditësi

Kundër

1. KBI XX, XX

2. Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Ilir Konushevcu nr.8, Prishtinë

Të Padturit

Kolegji i Specializuar i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Kryesues i Kolegjit, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, lëshon këtë

A K T G J Y K I M

- 1. Padia refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Paditësi obligohet që të paguajë tarifat gjyqësore në shumë prej 125 euro.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 22 dhjetor 2008, Paditësi ka ushtruar padi pronësore për ngastrën kadastrale nr. 1467/2, në sipërfaqe prej 0.47.33 ha, në vendin “Slani Potok”, Zona Kadastrale Çagllavicë, e regjistruar në emër të Kosova Export sipas fletës poseduese Nr.222, Komuna e Prishtinës. Ai kërkon regjistrimin e pronës në regjistrat kadastral në emër të tij si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

I ati i Paditësit, trashëgimtari i vetëm i të cilit është Paditësi, ishte bashkëpronar i kësaj ngastre bashkë me S.T., R.T. dhe I.T.

Komisioni për Komasacion në Kuvendin Komunal të Prishtinës me Vendimin Nr. 35/63 të datës 24 janar 1964 ia ndau pronën e përmendur KBI XX në këmbim me për ngastrën kadastrale nr.273, me sipërfaqe prej 0.54.43ha, ZK Çagllavicë, Komuna e Prishtinës. Në këtë vendim vetëm A.T. është i emëruar si pronar i ngastrës nr. 1467/2.

Ngastra 273 asnjëherë nuk u transferua apo regjistrua tek Paditësi apo i ati i tij dhe më vonë ajo u regjistrua në emër të personave tjerë fizikë. Ndërsa, i ati i paditësit dhe Paditësi pa ndonjë ndërprerje vazhduan ta kultivojnë ngastrën e mëparshme nr.1467/2. Arsyeja për këtë është se NSH-ja i deklaroi të atit të Paditësit se NSH-ja do të kryente të gjitha punët në lidhje

me dokumentet që toka të regjistrohet dhe se ata do të mund të vazhdonin të kultivonin tokën e tij derisa kjo procedurë të zgjaste. As Padiësi e as i ati i tij nuk iniciuan asnjëherë procedurë administrative, padi gjyqësore apo kërkesë për ndryshime kadastrale të pasurisë e cila do të duhej t'u ndahej atyre në shkëmbim. Ngastra kadastrale 273 asnjëherë nuk ishte në posedim të familjes së Padiësit ndërsa ngastra kadastrale 1467/2 mbeti në posedim të familjes së Padiësit.

Më 2 qershor 2009, Padiësi dorëzoi një certifikatë të datës 25 maj 2009 nga Komuna e Prishtinës për regjistrimin aktual dhe historinë e pasurisë: ngastra kadastrale nr. 1467/2, e regjistruar si pronë shoqërore, në emër të KBI XX, ndërsa ngastra kadastrale Nr. 273 para vitit 1999 ishte regjistruar në emër të katër bashkëpronarëve, gjegjësisht J., M., S. dhe S.J. dhe pas vitit 2005 ajo ishte ndarë në mes të 11 personave.

Më 14 janar 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si administruese e NSH-së së Paditur u ftua në padi si e Paditur e dytë.

Në mbrojtjen në padi të datës 19 shkurt 2010, AKP-ja paraqet se padia duhet të refuzohet si e papranueshme ose si e pabazuar. AKP-ja konsideron se vendimin mbi komasacionin si një vendim administrativ i detyrueshëm nuk mund të anulohet përmes një procedure të re kontestimore.

Më 20 janar 2011, Trupi Gjyqësor lëshoi një aktvendim me të cilin e refuzoi padinë si të pabazuar. Gjykata konsideroi se vendimi për komasacionin i vitit 1964 nuk ishte kundërshtuar sipas Ligjit mbi Procedurën Administrative të vitit 1986 dhe se pronësia e pasurisë së shkëmbyer do të ishte çështje e përmbarimit të vendimit e jo e vlefshmërisë së tij. Padia pronësore në bazë të parashkrimit fitues do të ishte e pabazuar në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (nr.6/1980).

Më 2 dhjetor 2011, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së e prishi aktvendimin e Trupit Gjyqësor dhe e ktheu lëndën për rigjykim. Kolegji i Ankesave konsideroi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar ligjin i cili nuk ishte në fuqi në kohën e vendimit të kundërshtuar (Ligji mbi Procedurën Administrative i vitit 1986) ndërsa çështja rregullohet sipas nenit 68(f) të Ligjit për Ndryshimet dhe Shfrytëzimin Tokës Bujqësore (GZ 49 RSFJ 30 dhjetor 1962), i cili parasheh se vendimet e Komisionit për Komasacion nuk mund të kontestohen në një procedurë administrative. Prandaj, Padiësi nuk e kishte mundësinë që të kundërshtonte vendimin mbi shpronësimin. Më tej, padia duhet të trajtohet si një padi pronësore me të cilën kontestohet shpronësimi. Kolegji i Ankesave vërtetoi se padi e padiësit në bazë të parashkrimit fitues është e pabazuar. Kolegji i Ankesave konsideroi se gjykata e shkallës së parë duhet të marrë qëndrim mbi bazat të cilat sipas padiësit shkaktuan pavlefshmërinë e shpronësimit.

Më 17 prill 2012, padiësi dorëzoi një zgjerim të padisë me të cilën L.T., R.T. dhe S.T. kërkuan të përfshihen në procedurë si të paditur. Padiësi paraqiti vendimin e trashëgimisë të datës 21 janar 1960 në bazë të të cilit trashëgimtarët e J.T. janë A.T., S.T., R.T. dhe L.T. Ai argumenton se ata e trashëguan pronën e kontestuar bashkë me të atin e tij. Megjithatë, prona ishte shpronësuar në mënyrë të gabuar vetën nga i ati i padiësit dhe prandaj vendimi i shpronësimit është i pavlefshëm.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 19 prill 2012 DHPGJS-ja e refuzoi zgjerimin e Padisë sepse i Padituri refuzojë të japë pëlqimin e tij ndaj zgjerimit dhe se padia mund të ishte

zgjeruar më herët dhe se me faj nuk ishte zgjeruar më herët (neni 258.4a i Kodit të Procedurës Kontestimore).

Arsyetimi ligjor

Paditës është vetëm A.D., e jo S.T., R.T. dhe L.T. Gjykata nuk i pranoi Paditësit tjerë sepse i Padituri e kundërshtoi atë dhe kjo do të kërkonte shtyrje për të vendosur për këta Paditësit tjerë. Gjykata konsideroi se Paditësi i cili e dorëzoi kërkesën e tij për të përfshirë Paditës të tjerë vetëm pas një procedure prej më shumë se tre vitesh dhe vetëm dy ditë para seancës dëgjimore përfundimtare ka vepruar me faj (neni 258.4a i Kodit të Procedurës Kontestimore).

Padia është e pabazuar.

Kjo rezulton tanimë nga fakti se Paditësi me padinë e datës 22.12.2008 kërkon që prona 1467/2 t'i dorëzohet atij dhe që ai të regjistrohet si pronar i kësaj prone, edhe pse ai e ka sqaruar përmes parashtresës së tij të datës 17.4.2012 që paraardhësi i tij ligjor T.J.A., ishte vetëm njëri nga katër bashkëpronarët e pronës. Paditësi do të mund të trashëgonte vetëm atë çka posedonte paraardhësi i tij. Kështu që edhe nëse vendimi i Komisionit për Komasacion i Kuvendit Komunal të Prishtinës Nr. 35/63 i datës 24 janar 1964 do të ishte i pavlefshëm, prona 1467/2 nuk do të mund t'i dorëzohej vetëm Paditësit dhe ai nuk do të mund të regjistrohej vetëm në kadastër. Edhe pronarët tjerë pastaj do të kishin të drejtën që të riemëroheshin si pronarë.

Por edhe pavarësisht kësaj, padia është e pabazuar.

Vendimi i kundërshtuar është lëshuar nga Komisioni për Komasacion i Komunës së Prishtinës në bazë të Ligjit mbi Shfrytëzimin e Tokave Bujqësore (RSFJ GZ 43/59) në lidhje me Dekretin numër 53 të datës 31 dhjetor 1962, Gazeta Zyrtare RSFJ 1962 (as vendimi nuk e përmend dekretin). Këto dispozita e përcaktonin procedurën për "Rindarje" të tokës në dobi të organizatave bujqësore.

Vendimi për rindarje sipas ligjit të lartpërmendur mund të kundërshtohet për arsye të ndryshme në dy procedura të ndryshme:

1. Ankesa tek autoriteti administrativ republikan përgjegjës për çështje bujqësore (neni 65 paragrafi 3 dhe neni 66 paragrafi 1 i Ligjit mbi Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore). Një Ankesë e tillë mund të mos e marrë parasysh çështjen e kompensimit.
2. Vetëm në lidhje me kompensimin, një propozim në gjykatë për të përcaktuar kompensimin me një procedurë jokontestimore (neni 66 paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit mbi Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore)

Megjithatë, Dekreti i lartpërmendur i vitit 1962 e kufizonte këshillën ligjore:

Sipas këtij Dekreti, rikthimi në gjendjen fillestare dhe rihapja e procedurës nuk ishte më e lejuar në procedurën e rindarjes (neni 68j). Kjo do të thotë se paditësi nuk kishte këshillë ligjore që t'i kthehej atij ngastra 1467/2. Dhe kështu vendimi për Rindarje mbeti i formës së prerë.

Megjithatë, paditësi nuk mund të kërkojë tani që të hiqet vendimi për rindarje dhe që ai të marrë sërish ngastrën e tij 1467/2.

Paditësi e kundërshton vendimin për rindarje mbi dy baza:

1. Vendimi emëronte vetëm një prej katër bashkëpronarëve;

2. Toka e premtuar për shkëmbim asnjëherë nuk iu dha paditësit apo të atit të tij.

Kundërshtimi i parë nuk mund të ngrehet nga Paditësi sepse i ati i tij nga i cili rrjedh e drejta e tij përmendet në vendimin për Rindarje. Fakti që tre bashkëpronarët tjerë nuk përmenden nuk ka asnjë ndikim në pozitën e paditësit. Në lidhje me Paditësin vendimi për Rindarje ishte ligjërish i saktë.

Kundërshtimi i dytë nuk ka të bëjë me ligjshmërinë e vendimit për Rindarje, por vetëm me përmbartimin e tij. Vendimi për rindarje ka mbetur i pa përmbartur si i tillë pasi që Paditësi nuk e ka marrë ngastrën 273. Por kjo nuk është ngastra të cilën Paditësi po e kërkon në rastin në fjalë.

Pasi që Kolegji i Ankesave në aktvendimin ASC-11-0045 të datës 2 dhjetor 2011 konsideroi se paditësi nuk kishte kërkuar pronësinë mbi kadastrën përmes parashkrimit fitues pasi që ligji i aplikueshëm në atë kohë nuk e parashihte atë mundësi. Ligji për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore i vitit 1996 e shfuqizoi ndalesën për fitimin e pronës shtetërore/shoqërore përmes parashkrimit fitues. Paditësi do të duhej të dëshmonte 20 vite të posedimit të pandërprerë që nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Gjykata gjithashtu konsideroi se Paditësit ia kishte lejuar NSH-ja që të vazhdonte kultivimin e ngastrës së tij të mëparshme 1467/2 deri sa NSH-ja të merrej me punët e dokumenteve të nevojshme për transferimin e tokës së shkëmbyer dhe se NSH-ja asnjëherë nuk e bëri një gjë të tillë. Ky fakt mund t'i jepte Paditësit të drejtën për posedim, por jo pronësinë apo të drejtën për të fituar pronësinë.

Pasi që Paditësi nuk është pronar i ngastrës 1467/2 dhe pasi që ai nuk ka të drejtë të bëhet pronar i ngastrës 1467/2, padia hedhet poshtë si e pabazuar.

Shpenzimet

Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe në pajtim me Rregullat Proceduralë në lidhje me Taksat Gjyqësore, të Dhomës së Posaçme, që janë në fuqi nga data 13 dhjetor 2010, tarifat e Dhomës në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/02 (ADJ) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë si vijon:

Shuma e tarifës për ushtrimin e padisë siç rregullohet me nenin 10.1 ADJ është 50 euro, pasi që kolegji i specializuar konsideron se vlera e padisë bie në kategorinë 5.001 deri 10.000 euro, duke marrë parasysh madhësinë e tokës në fjalë. Neni 10.12 ADJ përcakton se për aktvendimet e shkallës së parë në bazë të vlerës së objektit tarifa paguhet sipas numrit tarifor 10.1 që është 50 euro.

Tarifa e taksës gjyqësore, neni 10.1 (ushtrimi i padisë)	50 euro
Tarifa e taksës gjyqësore, neni 10.12 (aktvendimi)	50 euro
Tarifa e taksës gjyqësore, neni 10.21 (procedura e ankesës)	100 euro

Gjithsej	200 euro
----------	----------

Shpenzimet e procedurës barten nga pala e pasuksesshme, në këtë rast nga Paditësi. Paditësi tanimë ka paguar shumën prej 75 euro, kështu që Paditësi do të paguajë në Dhomën e Posaçme shumën e mbetur prej 125 euro.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjykses **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk, Kryesues i Kolegjit

[nënshkruar]

Urdhër i brendshëm

Ky aktvendim t'u dërgohet palëve